

Në pajtim me statutin e BPrAL »Kolegji ESLG«, Bordi Drejtues i ESLG-së më 20.08.2019 nxjerr si në vijim:

RREGULLORE PËR REGJISTRIM DHE TRANSFER NË STUDIMET BACHELOR

1. Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Kjo rregullore rregullon regjistrimin dhe transferin në vitin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve të rregullta dhe me korrespondencë në nivelin bachelor.

Neni 2

Studenti ka të drejtë të regjistrohet katër herë gjatë studimeve bachelor: 1) në vitin e parë (trimesistri i parë, i dytë dhe i tretë), 2) vitin e dytë (trimesistri i tretë, i katërt dhe të pestë), viti i tretë (trimesistri i gjashtë, i shtatë dhe i tetë), dhe si absolvent (12 muaj).

2. Kushtet për regjistrim në vitin e parë

Neni 3

Kushtet e përgjithshme

(1) Në vitin e parë të studimeve L.L.B në Juridik që mbahet në gjuhën angleze regjistrohet student i cili përmbush kushtet si në vijim:

- Ka përfunduar me sukses provimin e maturës
- Ka përfunduar me sukses shkollën e mesme me notë mesatare mbi 3.5
- Ka përfunduar testin TOEFL me rezultat 500 e më shumë.

(2) Në vitin e parë të studimeve BA në Juridik dhe Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës që mbahet në gjuhën angleze regjistrohet student i cili përmbush kushtet si në vijim:

- Ka përfunduar me sukses provimin e maturës
- Ka përfunduar me sukses shkollën e mesme me notë mesatare mbi 3.5
- Ka përfunduar testin TOEFL me rezultat 500 e më shumë.

(3) Në vitin e parë të studimeve BA në Juridik dhe Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës që mbahet në gjuhën shqipe regjistrohet student i cili përmbush kushtet si në vijim:

- Ka përfunduar me sukses provimin e maturës
- Ka përfunduar me sukses shkollën e mesme me notë mesatare mbi 3.5

- (4) Për studentët të cilët nuk ka qenë i vlefshëm Provimi i Maturës në momentin e diplomimit të tyre nga shkolla e mesme vlen vërtetimi i notës mesatare të fituar gjatë studimeve në shkollën e mesme.
- (5) Studentët të cilët kanë përfunduar studimet e arsimit të mesëm jashtë vendit duhet të plotësojnë të njëjtat kushte sikur kandidatët që i kanë kryer studimet e arsimit të mesëm brenda Kosovës, gjatë së cilës bëhet ekuivalentimi i notave që kandidati i ka marrë gjatë shkollimit jashtë vendit me sistemin e notave në fuqi në Kosovë.

Neni 4

Në rast të numrit të kufizuar të regjistrimeve në ESLG, kriteret e përmendura mëlartë do të kenë peshën si në vijim gjatë vendimit të regjistrimit të studentit

(1) Për studentët në programin Juridik në gjuhën angleze:

- Provimi i Maturës 25 %;
- Nota mesatare gjatë studimeve në shkollën e mesme 50 %;
- Rezultati i arritur në testin e gjuhës angleze TOEFL 25 %;

(2) Për studentët në programin Juridik dhe Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës që mbahet në gjuhën angleze

- Provimi i Maturës 25 %;
- Nota mesatare gjatë studimeve në shkollën e mesme 50 %;
- Rezultati i arritur në testin e gjuhës angleze TOEFL 25 %;

(3) Për studentët në programin Juridik dhe Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës që mbahet në gjuhën shqipe

- Provimi i Maturës 30 %;
- Nota mesatare gjatë studimeve në shkollën e mesme 70 %;

(4) Komisioni për Studime është përgjegjës për vendimin për regjistrimin e studentëve.

Neni 5

(Aplikimi)

(1) Studenti i cili përmbush kushtet për regjistrim në vitin e parë të parashikuar me nenin 4 të kësaj rregullore duhet të dorëzojë dokumentet si në vijim:

1. formularin e nënshkruar për aplikim;
2. Originalin ose kopjen e vërtetuar të provimit të maturës;
3. Originalin ose kopjen e vërtetuar të diplomës së shkollës së mesme;
4. Originalin ose kopjen e vërtetuar të dëftesave të shkollës së mesme;
5. fotokopjen e çertifikatës së lindjes;
6. Në rast se studentin është transferuar nga ndonjë universitet apo kolegji i akredituar në Kosovë apo jashtë vendit studentin gjithashtu duhet të dorëzojë çertifikatën e notave nga ai institucion;

3. Kushtet për regjistrim në vitin më të lartë

Neni 6

(Kushtet e përgjithshme)

(1) Studenti regjistrohet në vitin e dytë të studimeve nëse mëparë ka përmbushur të gjitha obligimet ndaj ESLG-së dhe ka dhënë me sukses provimet e vitit të parë të cilat përbëjnë 30 kredi ECTS.

(2) Studenti regjistrohet në vitin e tretë të studimeve nëse mëparë ka përmbushur të gjitha obligimet ndaj ESLG-së dhe ka dhënë me sukses të gjitha provimet e vitit të parë dhe provimet e vitit të dytë që së paku përbëjnë 30 kredi ECTS.

(3) Studenti regjistrohet në vitin më të lartë të studimeve brenda afatit të specifikuar për regjistrimin e vitit që është 30 shtator. Kjo dispozitë vlen edhe për studentët që përsërisin vitin.

Neni 7

Studenti mundet të regjistrohet me kusht në vitin e tretë të studimeve nëse i mungon një provim për të plotësuar kushtin për regjistrim:

- Nëse paraprakisht ka përfunduar provimet e vitit të parë;
- Nëse jep provimin përkatës më së largu deri në përfundimin e Trisemestrit të parë të vitit të tretë.

Neni 8

(1) Kushti për regjistrim në vitin më të lartë akademik është gjithashtu i mundshëm edhe pa përmbushjen e kushteve të parashikuara me nenet e mësipërme nëse student i ofron dëshmi të bazuar.

(2) Dëshmi e bazuar është materniteti apo sëmundja e cila ka zgjatur për më shumë se dy muaj gjatë periudhës së mbajtjes së provimeve apo nëse student i gjatë kohës së mbajtjes së provimeve ka marrë pjesë në aktivitete profesionale, kulturore dhe sportive për të cilat institucioni mendon se ngrisin imazhin e ESLG-së.

(3) Komisioni për Studime vendos nëse një student mund të regjistrohet në vitin më të lartë edhe pa plotësuar kushtet e mësipërme si në nenet paraprake.

Neni 9

Kalimi nga studimet e rregullta në studimet me korrespondencë

(1) Studenti i cili në vitin paraprak ka qenë duke studiuar me korrespondencë mundet të regjistrohet në vitin më të lartë në studime të rregullta nëse ka plotësuar kushtet për regjistrim në vitin më të lartë dhe nëse numri i regjistrimeve si student i rregullt nuk është i kufizuar.

(2) Përparësi do të kenë ata kandidat të cilët kanë arritur sukses me notë mesatare më të lartë gjatë vitit paraprak akademik.

(3) Studenti i cili në vitin paraprak ka qenë i regjistruar si student i rregullt mundet të regjistrohet në vitin më të lartë si student jo i rregullt nëse ka plotësuar kushtet për regjistrim në vitin më të lartë.

(4) Kërkesën për kalim nga studimet e rregullta në studime me korrespondencë dhe anasjelltas studenti duhet t'a bëjë jo më larg se deri më 30 shtator të vitit përkatës.

4. Kushtet për përsëritjen e vitit

Neni 10

(1) Studenti i cili nuk ka përmbushur të gjitha kushtet për regjistrim në vitin më të lartë mundet të përsërit vitin vetëm njëherë.

(2) Përjashtim nga ky rregull bëjnë studentët të cilët ofrojnë arsye bazë siç është materniteti, sëmundja e cila ka zgjatur më shumë se dy muaj gjatë kohëzgjatjes së mbajtjes së provimeve apo ka marrë pjesë në aktivitete profesionale, sportive dhe kulturore të cilat ESLG-ja i konsideron se e ngrisin imazhin e ESLG-së për shkak të aktiviteteve ekstrakurrikulare të studentit.

(3) Studentet të cilat lindin fëmijë kanë të drejtë që të shtyejnë përfundimin e studimeve për një vjet për secilin fëmijë të lindur.

5. Vazhdimi i studimeve pas ndërprerjes

Neni 11

Studenti i cili ndërpre studimet për më pak se dy vite ka të drejtë të vazhdojë studimet me të njëjtin planprogram siç ka qenë në fuqi në kohën e regjistrimit të tij/saj.

6 Kohëzgjatja e absolventit

Neni 12

(1) Pas përfundimit të trimeshtrit të fundit studenti ka kohë edhe 12 muaj që të përfundojë studimet.

(2) Kohëzgjatja e absolventit prej 12 muaj mundet të shtyhet edhe për një vjet tjetër nëse studenti ofron arsye të qëndrueshme siç janë: materniteti, sëmundja apo pjesëmarrja në aktivitete profesionale, sportive dhe kulturore të cilat ESLG-ja i konsideron se e ngrisin imazhin e ESLG-së për shkak të aktiviteteve ekstrakurrikulare të studentit.

Kushtet e regjistrimit si student transfer nga institucionet tjera të arsimit të lartë të akredituara në Kosovë dhe jashtë vendit

Neni 13

(Transferi në Programin Juridik)

(1) Studenti mundet të transferohet në programin Juridik të ESLG-së nga secili program Juridik i akredituar në Kosovë dhe jashtë vendit.

(2) Studenti do të transferohet direkt në vitin e dytë të studimeve Juridik L.L.B nëse në institucionin tjetër të akredituar të arsimit të lartë ka përfunduar vitin e parë dhe ka dhënë provimet që së paku përbëjnë 30 ECTS kredi të cilat njihen nga Komisioni për Studime i ESLG-së si provime të bartura.

(3) Studenti do të transferohet direkt në vitin e tretë të studimeve Juridik L.L.B nëse në institucionin tjetër të akredituar të arsimit të lartë ka dhënë të gjitha provimet e vitit të parë dhe së paku provimet e vitit të dytë të cilat përbëjnë 30 ECTS kredi dhe të cilat njihen nga Komisioni për Studime i ESLG-së si provime të bartura.

(4) Studenti është i obliguar që të jap të gjitha provimet të cilat parashihen me planprogramin e akredituar Juridik të ESLG-së dhe të cilat nuk kane qenë pjesë e planprogramit të programit studimor Juridik nga institucioni tjetër i akredituar në Kosovë dhe jashtë vendit.

Neni 14

(Transferi në Programin Juridik dhe Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës)

Për shkak se programi i studimeve Juridik dhe Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës BA është program unik dhe interdisciplinar kushtet për transferim në këtë program nga programet tjera të institucioneve tjera të akredituara në Kosovë dhe jashtë vendit janë si në vijim:

(1) Në vitin e dytë të studimeve mund të transferohen studentët të cilët kanë përmbushur kushtet si në vijim:

- a) Kenë përfunduar Shkollën e Lartë sipas sistemit të vjetër të arsimit të lartë që ka qenë në fuqi në Kosovë dhe në ish RSFJ në këto drejtime: 1) shkenca administrative dhe afariste; b) shkenca juridike; c) matematikë; dhe d) shkenca të arkitekturës dhe ndërtimtarisë dhe shkenca të gjeografisë. Studentët në fjalë duhet të japin në ndërkohë gjatë vazhimit të studimeve këto provime diferenciale të programit të patundshmërive të ESLG-së: 1) Arkitektura 2) Hyrje në Planifikim Urban dhe 3) Vlerësimi i Paluajtshmërive;
- b) Kenë përfunduar studimet universitare në ndonjë degë tjetër e cila nuk lidhet me kompetencat bazë të programit interdisciplinar siç janë 1) shkencat administrative dhe afariste; b) shkenca juridike; c) matematikë; dhe d) shkencat e arkitekturës dhe ndërtimtarisë. Studentët në fjalë duhet të japin në ndërkohë gjatë vazhimit të studimeve katër provime diferenciale të vitit të parë: 1) E Drejta Pronësore; 2) Hyrje në Planifikim Urban; c) Arkitektura dhe d) Vlerësimi i Patundshmërive.

(2) Në vitin e tretë të studimeve mund të transferohen studentët të cilët kanë përmbushur kushtet si në vijim:

- c) Kanë përfunduar studimet universitare në një nga këto drejtime: 1) shkenca administrative dhe afariste; b) shkenca juridike; c) matematikë; dhe d) shkenca të

arkitekturës dhe ndërtimtarisë. Studentët në fjalë duhet të japin në ndërkohë gjatë vazhimit të studimeve këto provime diferenciale të programit të patundshmërive të ESLG-së: 1) E drejta pronësore dhe 2) Hyrje në Planifikim Urban; 3) Hyrje në Menaxhim;

Neni 15

(1) Studentët mundën të regjistrohen si student transfer në programin Juridik L.L.B vetëm nga ndonjë program juridik i Fakultetit Juridik të një universiteti, kolegji apo institucioni të arsimit të lartë të akredituar në Kosovë apo jashtë vendit.

(2) Vendimin për pranimin e provimeve e merr Komisioni për Studime pasi të ketë shqyrtuar planprogramin mësimor të programit Juridik të institucionit tjetër të arsimit të lartë.

(3) Studentët mundën të regjistrohen si student transfer në programin Juridik dhe Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës BA vetëm nga ndonjë program studimor nga a) shkencat administrative dhe të biznesit; b) juridikut; c) ekonomisë; dhe d) arkitekturës dhe ndërtimtarisë të një universiteti, kolegji apo institucioni të arsimit të lartë të akredituar në Kosovë apo jashtë vendit.

(4) Vendimin për pranimin e provimeve e merr Komisioni për Studime pasi të ketë shqyrtuar planprogramin mësimor të programeve në fjalë të universiteteve, kolegjeve apo institucioneve të arsimit të lartë të akredituara në Kosovë apo jashtë vendit.

Në Prishtinë, më 20.08.2019

Prof. Dr. Edmond Hajrizi
Kryetar i Bordit Drejtues

